

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, sipas gjyqtares Mevlide Shabani, me sekretaren juridike Hyrije Sylejmani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit I.M. R.nga f.D. K.K.Gj., të cilin e përfaqëson me autorizim B. I.jurist nga Gjilani, kundër të paditurit G. M. A. nga P.,Rr.... nr..., për shkak të njohjes së të drejtës së pronësisë në bazë të kontratës, jashtë seancës gjyqësore me datë 16.08.2016, bie këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **NË BAZË TË POHIMIT**

**I.APROVOHET** si e bazuar kërkesë padia e paditësit I.M. R.nga fshati Dobërçan K.K.Gjilan,kundër të padituri G. A.nga P., dhe **VËRTETOHËT** se paditësi është pronarë i ngastrave katastrale me numër të njësisë P-..., në sipërfaqe prej ... m2, si dhe ngastrës katastrale me numër të nr.njësisë P-..., në sipërfaqe prej ... m2, të cilat gjinden në vendin e quajtur "... " zona katastrale D., ZK Gj., në bazë të kontratës gojore mbi shitblerjen si dhe mbajtjes.

**II.OBLIGOHET** i padituri që paditësit tia pranojnë të drejtën e pronësisë dhe të përmbahet që kjo palujetshmëri në DGJKPB në Gjilan të regjistrohet në emër të paditësit , në afat prej 15.ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, kurse paditësi obligohet që në emër të përpilimit të aktgjykimit të ia paguaj kësaj gjykate shumen prej 25 €.

## **A r s y e t i m**

Paditësi I.M. R.nga f.D. K.K.Gj., përmes përfaqësuesit të tij B. I.jurist nga Gj., në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit G. M. A. nga P.,për njohjen e së të drejtës së pronësisë , në të cilën ka theksuar se me anë të kontratës gojore në vitin ..., paditësi me babain e të paditurit në prezencën e vetë të paditurit në shumë të përgjithshme prej ... Franga Zvicrrane, kishte lidhur kontratë gojore mbi shitblerjen e palujtëshmërive dhe atë të njësisë P-... lloji i pronës- parcelë, tokë bujqësore, vendin e quajtur "... " në sipërfaqe prej ... m2, dhe numër të njësisë P-... lloji pronës parcelë tokë bujqësore, vendin e quajtur "... "në sipërfaqe prej ... m2, të cilat evidentohen në bazë të certifikatës së pronës e datës ...11.2015 ZK. D., të cilat palujtëshmëri evidentohen në emër të babait të paditurit M. A.. Kanë shtuar se paditësi prej momentit të blerjes së

ngastrave në fjalë e edhe më tani i shfrytëzon këto ngastra duke qenë i pa penguar nga askush.

I padituri G. M.A. në përgjegje në padi ka deklarua se e pranon padinë dhe kërkesë padinë e paditësit I. R. se është e vërtetë se ia ka shitur palujtëshmëritë- ngastrat katastrale të cekura në padi, tokë bujqësore në vendin e quajtur "... " në sipërfaqe prej ... m2 dhe ... m2, në shumën prej ... Franga Zvicrrane. Gjithashtu i njëjti ka deklarua se të njëjtat ngastra në momentin e shitjes në prezencën e babait të tijë, ia kanë dorzuar në shfrytëzim dhe në pronësi paditësi dhe i njëjti kurrë nuk është penguar nga askush dhe tani i shfrytëzon këto ngastra katastrale i pa penguar.

Lidhur me këtë gjykata ka arritur qëndrimin juridik për faktin se i padituri e ka pranuar padinë dhe kërkesë padinë e paditësit dhe pa u lishuar në administrimin e provave ka vendosur si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në pajtim me nenin 452 paragrafi 4 të LPK-ës.

Nga arsyerat e theksuara më lartë dhe në bazë të nenit 143 dhe 148 parag. 1 të LPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

Më dt.16.08.2016

**Gjyqtarja**

Mevlide Shabani d.v.

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtës. Ankesa dorzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.